



## REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.173/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS- Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha kryetar, Dren Rogova dhe Ramush Bardiqi, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Medical Group shpk me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokatura Ramaj&Palushi në Prishtinë, kundër të paditues Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, vlersim tatimor, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditues kundër aktgjyqimit të Gjykatës Komerciale-Dhoma e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, KF.nr.11/22 i datës 12.10.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 28.03.2024, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e të paditues Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Komerciale-Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, KF.nr.11/22 i datës 12.10.2023, Vërtetohet

### A R S Y E T I M

Me aktgjykimin e ankimuar, Dhoma e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitiv të aktgjyqimit: I.Aprovohet në tërsi si e bazuar Kërkesëpadia e paditësit Medical Group shpk me seli në Prishtinë, II. Anullohet pjesërisht vendimi i të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë nr.26/2019 i datës 13.03.2019, dhe atë vetëm në pjesën që i referohet mospranimin nga ATK-së të shumës prej 256,332.00€ si kthim i mjeteve të parapaguara në vitin 2017, sipas aktgjyqimit të plotëfuqishëm I.C.nr.20/2013, dhe të ardhurat nga shitja e tri veturave në shumën prej 24,138.62€, për vitin 2016, III. Obligohet e paditura Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, që paditësit Medical

Group shpk me seli në Prishtinë, t,ia kthej mjetet e paguara më tepër dhe atë në emër të përlllogaritjes së TVSH-së dhe Tatimit në të Ardhura për periudhën 2015-2018 shumën prej 27,428.23€, në emër të ndëshkimeve shumën prej 4,000.00€, e të gjitha këto së bashku në shumën e përgjithshme prej 31,428.23€, me kamatë ligjore në shkallën e përcaktuar ng Ministria e Financave e Republikës së Kosovës, në lidhje me secilin muaj kalendarik në mes të datës së pagesës e gjer në nxjerrjen e këtij aktgjykimi, krejt këto në afat prej 15 ditësh nga dita e nxjerrjes se këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbaramit ligjor, IV. Vlersimet tjera tatimore jo kontestuese dhe atë në shumën prej 3,737.92€ në emër të TVSH-së dhe shumën prej 3,054.85€ në emër të tatimit në të ardhura për periudhën 2015-2018, mbesin në fuqi sipas raportit të Kontrollit datës 05.12.2019 të ATK, të vërtetuar me vendimin kontestues nr.26/2019 dt.13.03.2019 dhe Njoftim vlerësimeve nga e paditura, V. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura ka ushtruar ankesë me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak të; shkeljes së dispozitave procedurale, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, dhe propozon që të aprovohet ankesa e ATK-së, si e bazuar, të anulohet Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, KF.nr.11/22 i datës 12.10.2023, dhe të mbetet në fuqi vendimi nr.26/2019 i datës 13.03.2019 i ATK-së, ose lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i Gjykatës Komerciale, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar pretendimet në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre si në vështrim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, dhe nenit 49 të LKA-së, gjen se;

Ankesa është e pabazuar

Nga shkresat e lëndës rezulton se në procedurën administrative të ankesave, e paditura Administrata Tatimore e Kosovës-Departamenti i Ankesave, me vendimin nr.26/2019 datës 13.03.2019, ka Refuzuar si të pabazuar ankesën e tatimpaguesit Medical Group shpk me seli në Prishtinë, në mbështetje të nenit 132/2 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën Administrative, në lidhje me paragrafin 2 të nenit 89 të Ligjit 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat dhe Njoftim Rivlerësimit e tatimit shtesë nga

kontrolli si dhe vendimi nr.2305/2018 dt.11.12.2018 i lëshuar nga Zgjona, vërtetohen si të bazuara.

Kundër këtij aktvendimi përfundimtar të nxjerr në procedurën administrative, nga Departamenti për Ankesa të ATK, paditësi Medical Group shpk me seli në Prishtinë, përmes përfaqësuesit të autorizuar avokatura Ramaj&Palushi në Prishtinë, me padi inicion konflikt administrativ, në gjykatën e shkallës së parë, e cila pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor të datës 12.10.2023, në praninë e përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse, e në mungesë të palës së paditur e ftuar në mënyrë të rregullt, dhe administrimit të provave, si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur, bie aktgjykimin e ankimuar, me të cilin Aprovon pjesërisht kërkespadin e paditësit, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Dhoma e shkallës së parë, në arsyetim të aktgjykimit thekson se e paditura trajtimin e shitjeve të tri veturave/automjeteve në muajin mars, qershor dhe nëntor të vitit 2016 e ka trajtuar në mënyrë jo të drejt si të hyrë nga shitja e medikamenteve dhe përkundër faktit se kjo shumë prej 24,138.62€, nga paditësi ka qenë e deklaruar në pasqyrën financiare të tatimit në të ardhura të vitit 2016, në pozicionin e veçantë si të hyra të tjera dhe asesi kjo shumë si më e lartë nga shitja e veturave përkatëse nuk është dashur të vlersohet nga e paditura si e hyrë nga medikamentet mjeksore, fakt ky i vërtetuar edhe me ekspertizën financiare datës 17.07.2023. Gjykata ka gjetur se e paditura trajtimin e kompensimit të aprovuar nga aktgjykimi i plotfuqishëm IC.nr.20/2013 respektivisht mjetet e pranuar nga Bosnaljek DD nga Sarajeva BH, në vitin 2017, e ka trajtuar si të hyrë për qëllime të TAK-ut duke e quajtur si kompensim dëmi, porse e njëjta shumë nuk është kompensim dëmi por është kthim i mjeteve të parapaguara për mallin që paraprikisht është paguar por i cili mall për shkak të skadimit të afatit të tij nuk ka mundur të shitet dhe si kategori e tillë edhe është aprovuar kthimi i atyre mjeteve sipas aktgjykimit si më lartë. Sa i përket ndëshkimimeve të aplikuara nga e paditura ndër vitet për periudhen e kontrollit në shumën prej 4,000.00€, ka gjetur se të njëjtat e kanë bazën ligjore nga neni 53 i Ligjit 03/L-222, porse në rastin konkret edhe përmes ekspertizës financiare është vërtetuar se paditësi ka krijuar dhe mirmbajtur të gjitha regjistrimet kontabël siq kërkohet me legjislacionin tatimor dhe nuk ka pasur asnjë mungesë të tyre. Vlersimet tjera tatimore jo kontestuese në shumën prej 3,737.92€ në emër të TVSH-së dhe në shumën prej 3,054.85€ në emër të tatimit në të ardhura për periudhen 2015-2018 mbesin në fuqi sipas raportit të kontrollit datës 05.12.2019 të ATK-së.

Dhomat e Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, i pranon në tërësi si të drejta dhe ligjore konkludimet juridike të Dhomës së shkallës së parë, sa i përket gjendjes faktike të çështjes, e gjithashtu aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave ligjore, dhe as me shkelje, të cilat gjykata e shkallës së dytë i vlerëson sipas detyrës zyrtare si në vështrim të nenit 194 të LPK-së.

Kolegji i dhomës së shkallës së dytë, vlerëson se Dhoma e shkallës së parë drejtë ka vendosur gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, në drejtim të thënieve në padi, përgjigjes në padi, dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor dhe ka vlerësuar drejtë, se kërkesë padia e paditësit është pjesërisht e bazuar, duke e aprovuar pjesërisht kërkespadin e paditësit, dhe ka anuluar pjesërisht vendimin kontestues të paditues.

Pretendimet ankimore të paditues, Kolegji, i shqyrtoi në tërësi në baza ligjore dhe i vlerëson se nuk janë të bazuara, sepse nuk janë të bazuara në prova dhe fakte të dëshmuara, andaj Kolegji gjen se aktgjykimi i ankimuar, nuk është i përfshirë me shkelje procedurale apo ligjore siç pretendohet në ankes. Kolegji i Dhomës së shkallës së dytë, vlerësoi se me të drejtë dhoma e shkallës së parë, në bazë të provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, të gjeturave nga ekspertiza financiare e datës 17.07.2023, legjislacionit tatimor, ka aprovuar kërkespadin e paditësit sa i përket shumës prej 256,332.00€ sepse nuk ka bazë ligjore të trajtohet si e hyrë e tatueshme, bazuar në nenin 3 par.1 nënp.8 i Ligjit 06/L-105 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave. Në këtë rast paditësi ka hyrë në raporte kontraktuale me furnizuesin e medikamenteve Bosnaljek DD nga Sarajeva, ku sipas Kontratës së nënshkruar e vitit 2009, janë parapa dispozitat kontraktuese sa i përket stokut të mallit në depo, nën garantimin se asnjë produkti nuk do të skadon afati i përdorimit. Për këtë shumë të ngarkuar me tatim shtesë të trajtuar si e hyre e tatueshme, nga e paditura, Kolegji vlerësoi se e paditura nuk ka mund ta vërtetoj me asnjë dëshmi tjetër se kjo shumë paraqet kompensim për mallin, përderisa nuk është vërtetuar me asnjë provë konkrete se paditësi ka pranuar nga furnizuesi mallra me afat të skaduar të cilat kanë qenë në depon doganore të furnizuesit Bosnaljek BH, por të njëjtat të hyra janë kthim i parapagimit. Prandaj edhe Kolegji vlerësoi se nuk gjen mbështetje ligjore vlersimi i të paditues që ta trajtoj si të hyrë e realizuar nga dëmshperblimi i mallit nga funitori.

Kolegji pranon konstatimet e Dhomës së shkallës së parë, e cila gjendjen faktike e ka vërtetuar edhe përmes ekspertizës financiare datës 17.07.2023, ku vlersimi tatimor me të cilin është ngarkuar paditësi rezulton të jetë pjesërisht i drejt, prandaj në këtë rast me të drejt Dhoma e shkallës së parë ka nxjer aktgjykimin me të cilin aprovon pjesërisht kërkespadin e paditësit dhe anulon pjesërisht vendimin nr.26/2019 dt.13.03.2019 i paditurit ATKsë, duke vendosur si ne dispozitiv të aktgjykimit.

Kolegji i Dhomave të shkallës së dytë, i shqyrtoi edhe pretendimet ankimore lidhur me shkeljet procedurale, pasi që gjykata e shkallës së parë ka dhënë afatin për ankesë ndaj aktgjykimit 15 ditë, sipas LKA-së, ndërsa këtu gjen zbatim Ligji 04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për ATK, ku afati për ankesën ndaj aktgjykimit të shkallës së parë është 60 ditë. Kolegji nga shkresat e lëndës vleroi se e paditura ka pranuar aktgjykimin e atakuar me datën 27.10.2023, ndërsa ankesën ndaj këtij aktgjykimi e ka dorzuar në gjykatë me datën 13.11.2023, që nënkupton se ankesa është paraqitur brenda afatit ligjor. Kolegji pranon pretendimet se Ligji 04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për ATK, është i zbatueshëm, edhe pas miratimit të Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, mirpo në këtë rast dhënia e gabueshme e këshillës juridike në aktgjykimin e atakuar prej 15 ditësh, Kolegji nuk e konsideroi si pretendim që ta prish aktgjykimin e atakuar, sepse nuk ka ndikuar në afatin e ankesës së të paditues.

Pretendimet e të paditues në ankes, Kolegji nuk i aprovoi si të drejta. E paditura në ankes nuk ka dhënë shpjegime të arsyeshme dhe të argumentuara të zbatuara nga kontrolli tatimor, për të mbështetur pretendimet se vlersimi i kontrollit gjen mbështetje në legjislacionin tatimor.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, Dhomat e shkallës së dytë, konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cënuar ligji në dëm të paditurës, sepse Kolegji, nuk ka gjetur dëshmi që do të mund të vërtetonte një gjendje tjetër faktike nga gjendja faktike e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, për arsye se e paditura, nuk ka ofruar prova të bazuara që do të ndryshonin gjendjen faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë. Andaj, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, aktgjykimi i ankimuar i Dhomës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet

vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, ngase nuk është shkelur ligji material në dëm të paditurës.

Mbi këtë gjendje të fakteve, Kolegji, vlerëson, se Dhoma e shkallës së parë, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike të çështjes në shqyrtim dhe drejtë ka zbatuar dispozitat e LKA-së dhe dispozitat e legjislacionit tatimor.

Nga sa u tha më lartë, e në kuptim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015 dhe neni 49 i LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.Dh.Sh.II.nr.173/24 datë 28.03.2024

Kryetari i Kolegjit-gjyqtari,

Krenar Berisha